

VENDIM
Nr.238, datë 3.10.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “CA -TV PËRMET”
SUBJEKTIT PERSON FIZIK: ANDUEL SHABANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin e KKRT-së, nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, person fizik z.Anduel Shabani, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z.Anduel Shabani, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “CA-TV Përmet”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Përmetit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati